
 Republika e Kosovës Republika Kosovo Republic of Kosova	<b>KRYETARI I KOMUNËS          PRESEDNIK OPŠHTINE          MUNICIPAL MAYOR</b>		 Komuna e Istogut Opština Istok Istog Municipality
	Nr.Br. 01-142/021	Data: Datum: 17.05.2021	

Kryetari i Komunës, në mbështetje të nenit 13 të Ligjit mbi Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dhe me qëllim të realizimit të projektit “Pagesat Direkte (Subvencione) për fermer” i cili mbështetet financiarisht nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, shpall:

## K O N K U R S

### Për kryerjen e punëve me Marrëveshje për Shërbime të veçanta

**Drejtoria:** Drejtoria për Bujqësi, Pylltari dhe Hidroekonomi

**Vendi i Punës:** Zyrtar/e për aplikime në pagesa direkte (Subvencione)

**Nr. i referencës:**

**Lloji i Pozitës:** Marrëveshje për Shërbime të Veçanta - kohëzgjatja 5 muaj,

**Numri i Ekzekutuesve:** 3 (tre)

**Orari i plotë:** 40 orë në javë

**Paga :** 350 €

#### Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Pranimi dhe verifikimi i aplikacioneve
- Digjitalizimi i parcelave
- Pranimi i kërkesave të ndryshme nga palët
- Pranimi i palëve
- Sistemimi dhe ruajtja e aplikacioneve
- Të mbajë shënime (data bazë) në EXCEL dhe kopje fizike
- Të ofroj fermerëve udhëzime të sakta për kompletimin e dokumentacionit
- Detyra shtesë të parapara sipas MBPZHR dhe mbikëqyrësi.

#### Kushtet e pjesëmarrjes në rekrutim :

Të drejtë konkurimi në këtë pozitë kanë shtetasit e Republikës së Kosovës të moshës madhore, të cilët kanë zotësi të plotë për të vepruar, janë në posedim të të drejtave civile dhe politike, kanë përgatitjen e nevojshme arsimore dhe aftësinë profesionale për kryerjen e detyrave dhe të cilët kanë aftësi fizike që kërkohen për pozitën përkatëse.

**Dokumentet:**

- Dëshmi të kualifikimit shkollor, Fakulteti i Bujqësisë
- Dy rekomandime
- Dokument identifikimi
- Certifikata e lindjes ose ekstrakti
- Përvoja e punës në programet Elpis dhe Efr
- Certifikata qe nuk jeni nën hetime

**Afati i Konkurimit:** Konkursi është i hapur tetë (8) ditë kalendarike nga data e publikimit.

Data e shpalljes së konkursit 17.05.2021 deri më 24.05.2021

**Paraqitja e kërkesave :** Aplikacionet merren në Qendrën për Shërbim me Qytetar, kati i I-rë, Zyra nr.100 dhe kërkesat e plotësuara dorëzohen personalisht në të njëjtën zyre.

**Mirëpritën aplikacionet prej meshkujve dhe femrave të të gjitha komuniteteve të Republikës së Kosovës.**

Kërkesat e dërguara pas datës se fundit dhe kërkesat e pakompletuara nuk do te pranohen.

